
ME AEROPLAN
PAR AVION
REPUBLIKA POPULLORE SOCIALISTE E SHQIPERISE
L 2.40
SHQIPERIA
POSTA AJRORE
SARANDA
60q
L 1.20
REPUBLIKA POPULLORE SOCIALISTE E SHQIPERISE
L 1.20
REPUBLIKA POPULLORE SOCIALISTE E SHQIPERISE
Rek., Aerv
Me kartel
457
3 IV. 1981
Ziyad Ebüzziya
P. K.: 440
A.R.
R
BALLSH
(Türkiye) İSTANBUL


Derg. (Exp.:) Mykerem Janina
Rep.: 309/1 BALLSH
(Albania)
İSTANBUL
13 IV 81
249
TIRANË
4 IV 81
P.T.

TDV İSAM
Kütüphanesi Arşivi
No 2E.2015

Ballsh - Rep.: 309/1 - 29 - III - 1987

Eeh, i dashur Zijad! Ja edhe një letër tjetër për ty. Natyrisht mendja më fluturon përditë tek ju, mendoj përditë ty edhe fëmijët e tu (edhe që tash u lënë vite të gjata, s'dij kurgjë as për ty, as për fëmijët). Ju, vetëm ju, familjarët e mi më të ngushtë, ti me fëmijët e tu më rrethuat me një dashuri që nuk ka shembull. Tash, i mbetur pa asnjë letër prej teje, këtë s'dij si ta shpjegoj. Edhe letra ime e fundit (para kësaj), edhe telegrami mbetën pa përgjigje. Vallë këto letrat e mia a i lexon apo jo? A mos të ka shkruar dikush prej këtej, që: mos të më shkrosh tashmë këtej e tutje edhe të presësh marrëdhënien? Ose ndonjë letër kush e din me çfarë përmbajtje nga ana e ime?

Zijad! Tani mosha ime po shkon drejt 100-vjeçarit. Natyrisht një rrugë e shkurtër më ka mbetur përpara. Siç të kam shkruar edhe herëra të tjera, duhej t'i kisha mbyllur sytë më parë. Por që po jetoj këtu. Ëhe të jetosh duke të humbur edhe ty, të vetmin njëri të shpirtit që e kam të ngulitur në zemër... nuk e dij, a mund ta përfytyrosh dot se ç'domethënë për mua?

Kam parasysh letrat e tua që më thoshje se «më shkro për çdo gjë që dëshiron, për çdo gjë që të shkon ndërmend, e unë do t'i plotësoj»; edhe në fakt kështu ke bërë. Vite dhe vite. Ashtu siç nuk e ka bërë kurkush përveç teje. Pikërisht në këtë vështrim këtu thoshin gjithë se nuk lind një Nënë ndonjë Zijad tjetër.

Jam natyrisht këtu i sëmurë. Nën mbikqyrje të mjekëve. Ata më rekomandojnë që të porosis ty edhe për disa ilaçe. Këtë, siç e përmenda më lartë,

t'a shkrova edhe në letrën para kësaj, si edhe në telegramin.

Dy gjëra shumë të vogëla po të kërkoj në këtë rast, po deshe, m'i dërgo: 1) një kartëpostalë me firmat tuaja. Vetëm sa të shoh emrat: Tëndin, të Alevës, të Talhait, të Danidit. Dua ta shikoj me mall (megë nuk e kam parë prej kohe) firmën e bukur të Alevës. Kujtoj letrat e saja aq të mrrekullueshme. 2) E dyta, gjithashtu, siç të shkroja në letrën para kësaj edhe në telegram, po të më dërgosh nga ilaçet që më dërgoje mujëpërmuaj më parë, vetëm atë preparatën vitaminoze me shumë elemente që quhet SUPRADYN (ose e gjashmja që quhet SURVITINË) do të më kesh ndihmuar shumë për forcimin e shëndetit tim.

Gjoni Romani yt m'i dërgonte këto, edhe shumë të tjera, me aq kujdes, me aq kujdes. Më ka dashur shumë edhe e marr me mend se sa duhet të jetë i trishtuar për mua. Të fala atij. Sipas mjekëve, natyrisht më duhen edhe ilaçe për zemrën si edhe të tjera. Por ky specialitetë vitaminoz SUPRADYN (sidomos tash në moshën time edhe me sëmundjet që kam) duhet mos të më mungojë nga një pilul për asnjë ditë. Katër a pesë vjet, që m'i kishje dërguar, më kanë pas ruajtuar shumë shëndet të mirë. Edhe për ty mund të jenë të dobishme. Forcojnë rezistencën e trupit. Sikurse, tash, një lajm, një letër prej teje, ka për të qenë forcë shpërtëror gjallërimi për mua si këto vitaminat Supradyn. Ju përqafoj të gjithë.

T'Tyke rem [illegible]

TDV İSAM
Kütüphanesi Arşivi
No 2E.2015